



Përshkrim i ofertave të përkujdesjes



Elementi i përkujdesjes 1: Koha e arritjes

Ora 6.45 deri 8.10

Një nga kujdestarët është i pranishëm dhe i pret nxënëset dhe nxënësit. Ekziston mundësia për të ngrënë një mëngjes të sjellë me vete, për të zgjidhur i pavarur detyrat e shtëpisë, për të lexuar ose luajtur.



Elementi i përkujdesjes 2: Ngrënie e drekës dhe përkujdesje

Ora 11.40 deri 13.20

Nxënëset dhe nxënësit marrin një ushqim dreke të shëndetshëm. Pas kësaj të gjithë bashkë vendosin gjërat në vend. Përkujdesja zgjat deri sa fillon përsëri mësimi i pasdrekës. E hëna, e marta, e enjtja vullnetarisht të bëjnë gjimnastikë J+S Kids. Për fëmijët që nuk kanë mësim pasdrekës elementi i përkujdesjes 2 mbaron në orën 13.20. Ata kthehen në shtëpi ose vizitojnë elementin e përkujdesjes 3.



Elementi i përkujdesjes 3: Përkujdesje për kohën menjëherë pas drekës

Ora 13.20 deri 14.55

Nxënëset dhe nxënësit munden të zgjidhin detyrat e tyre të shtëpisë në mënyrë të pavarur në ambientet e përkujdesjes (pa u mbikqyrur). Më pas janë në dispozicion lojra të ndryshme. Elementi i përkujdesjes 3a mbaron me pauzën e mësimit të pasdrekës.



Elementi i përkujdesjes 4: Vakt ushqimi i ndërmjetëm dhe përkujdesje

Ora 14.55 deri 18.00

Nxënëset dhe nxënësit marrin një vakt ushqimi të ndërmjetëm (Zobig). Më pas ata munden të zgjidhin detyrat e tyre të shtëpisë në mënyrë të pavarur në ambientet e përkujdesjes (pa u mbikqyrur). Për nxënëset dhe nxënësit e tjerë dhe më vonë edhe për ata që i kanë kryer detyrat e shtëpisë janë në dispozicion lojra të ndryshme. Në pasdrekën e vonë nxënësit kthehen në shtëpi sipas planit të tyre individual. Ky interval kohor zgjat deri në mbarimin e strukturave ditore maksimumi deri në orën 18.00.



Elementi i përkujdesjes 5: Dreka "Eat & Go", në orën 12.00

Ushqimi mund të merret në dhomen e FEB (ndërtesa e shkollës filllore, Kirchstrasse 19) dhe më pas nxënësit mund të hanë në dhomen e perbashket të shkollës së sipërme në dhomen e ndejes.

Një pjatë menuje (qimi special Fr. 9.- në vend të 14.95) mund të blihet tek FEB dhoma ose në sekretariat. Ju gjithashtu mund të merrni me vete pjatën tuaj të ripërdorshme. Nxënësit janë përgjegjës për ruajtjen dhe pastërtin e enëve.



Detyrat e shtëpisë në Elementi i përkujdesjes (klubi i detyrave të shtëpisë) për ciklin fillor

Elementi i përkujdesjes L_a: 3./4. Primarstufe: Ora 13.20 deri 14.05 të hënën, të martën dhe të enjten

Në Elementi i përkujdesjes nxënëset dhe nxënësit e ciklit fillor zgjidhin në mënyrë të pavarur detyrat e tyre të shtëpisë nën mbikqyrje. Personi kujdestar parimisht kujdeset që fëmijët të mund t'i kryejnë në qetësi detyrat e tyre të shtëpisë. Ai kontrollon nëse janë kryer detyrat e shtëpisë, por nuk ka përgjegjësinë e ndihmës dhe të korigjimit. Për të ndihmuar është i pranishëm një mësimdhënës. Pas mbarimit të detyrave të shtëpisë fëmijët kalojnë në elementin e përkujdesjes 3 ose shkojnë në shtëpi.



Detyrat e shtëpisë në Elementi i përkujdesjes (klubi i detyrave të shtëpisë) për ciklin fillor

Elementi i përkujdesjes L_b: 3./4. Primarstufe: Ora 15.15 deri 16.00 të hënën, të martën dhe të enjten

Elementi i përkujdesjes L_c: 3./4. Primarstufe: 16.05 deri 16.50 të hënën, të martën dhe të enjten.

Elementi i përkujdesjes fillon në orën 15.15 dhe mbaron maksimumi në orën 16.50. Pas mbarimit të detyrave të shtëpisë fëmijët kalojnë në elementin e përkujdesjes 4 ose shkojnë në shtëpi.

Orë e të mësuarit për ciklin 5./6. Primarstufe e Sekondar dy hëra në javë sipas planit të tyre individual.



Kujdesi për pushime gjatë festave të karnevaleve dhe të Pashkëve

Oferta e kujdesis për pushime

Si përpjekje e parë në vitin shkollor 2023/24, oferta për kujdesin ndaj fëmijëve do të ofrohet për një javë gjatë festave të karnevalit, festave të Pashkëve dhe pushimet e vjeshtës ofrohet për një javë. Tre javë ofrohen gjatë pushimeve verore.

FEB (Kujdesi plotësues Familjar) në shkollën Nebikon ofron kujdes gjatë gjithë ditës nga ora 7.00 deri në orën 18.00 më së voni gjat këtyre javëve të festave.

Përshtatshmërisë

Oferta e kujdesit për pushime është kryesisht në dispozicion për fëmijet që përdorin gjithashtu ofertat FEB gjatë orarit të shkollës.

Kohët e kujdesit dhe vaktet

Orari i mbërritjes nga ora 7.00 deri në orën 9.00 përcaktohet paraprakisht ndërmjet kujdestarit ligjor dhe kujdestarit dhe është i detyrueshem.

Kujdesi gjatë gjithë ditës zgjat nga ora 7.00 deri në orën 17.00/18.00 duke përfshirë vaktet: mëngjes në orën 8.00, drekë në orën 12.00 dhe një vakt pasditje.

Regjistrimi në mëngjes përfshin mëngjesin (në orën 8.00) dhe drekën dhe përfundon në orën 13.15.

Regjistrimi mesdite-pasdite fillon nga ora 11.45Uhr deri në orën 17.00 (më së voni 18.00 ora).Dreka së bashku dhe një vakt pasditje janë të përfshira.

Për më shumë informacione dhe formularët e regjistrimit për kujdesi e pushimeve ju lutemi kontaktoni menaxheren e FEB, Erika Knüsel, Mail: feb@schule-nebikon.ch, Tel: 079 869 03 15.

A keni ndonjë pyetje të mëtejshme në lidhje me FEB - Kujdesi Plotësues Familjar? Ju lutemi kontaktoni një person kyç në gjuhën tuaj. Personat kyç për gjuhë të ndryshme janë renditur në broshurën e shkollës së verdhë, faqe 23/24 ose www.schule-nebikon.ch nën – personat kyç.

Albanisch